

VENDIM
Nr.723, datë 1.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS MARTANESH TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Martanesh të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Martanesh të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.148, datë 11.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Martanesh, të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Martanesh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Martanesh

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
32,33,118,121,123,240,243,244,255,256,257,258,259,260,261,263,264,265,266,267,268,269,270,274,276,278,280,282,284,286,289,292,295,297,300,304,310,312,316,317,319,144,145,146,161,162,163,170,172,174,177,181,186,189,191,194,197,199,201,204,207,214,216,223,236,246,248,250,252,254,160,112,116,88,90,66,119,229,242	Pyje dhe kullota	Në pronësi
673-674	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
675-681	Varrezat publike	Në pronësi
682-689	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
690-695	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin	Në pronësi

	publik.	
696-698,702,703,707-710,712,713,715,716,719,720	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
699,700,701,704,705,706,711,714,717,718,721,722	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
728-738	Infrastrukturë (Rrugë vendore)	Në pronësi
739	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi